

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Përmirësimi i Sistemit Audio-Video”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje audio-vizuale-32321200-1; Materiale audio-vizuale 32321300-2; Pajisje multimedia 32322000-6; Aksesorë të pajisjeve të audio dhe video 32350000-1 Pjesë të pajisjeve të audio dhe video 32351000-8

**VLERA E FONDIT LIMIT: 10,245,767 (dhjetë milion e dyqind e dyzetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:****1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3

*Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe ne mbështetje të nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:****2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

*Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.*

2. Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertave, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe shtojcës 9 të DST-së.*

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlloritur kontratës që prokurohet**, lëshuar nga

autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:

Pika 2/b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar: ....”. Vlera e përlllogaritur është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

#### **2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të para**

qesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi në përputhje me dispozitat ligjore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

#### **2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit kryesorë të kualifikuar të mëposhtëm:**

- 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve;
- 1 (një) i punonjës të certifikuar në fushën e pajisjeve fotografike të ofertuara ose ekuivalent;

Disponimi i punonjësve do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentet që duhet të paraqiten nga operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, janë:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Dëshmi/certifikata kualifikimi përkatëse të kërkuar më sipër, të lëshuar nga institucione kombëtare/ndërkombëtare të liçensuara/të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalent. Certifikatat duhet të jenë të verifikueshme ose të paraqiten kontakte të prodhuesit të vlefshme në rast nevojë për verifikim.
- Si dhe të figurojë në Listpagesat e subjektit për 3 muajt e fundit.

Një punonjës, mund të ketë një ose disa certifikime.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërma b) dhe c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllëgaritur si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është e domosdoshme, pasi tregon se operatorët ekonomikë disponojnë një staf tekniko-profesional të punësuar që do të angazhohen për të përmbushur me sukses dhe në kohë kontratën brenda një periudhe prej 60 ditësh, bazuar në zërat e preventivit, sasitë dhe specifikimet teknike të pajisjeve që nevojiten për të instaluar, konfiguruar dhe që do të mbikqyrin të gjithë procesin nga porositja, magazinimi, transportimi deri tek instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve, si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së garancisë parashikuar sipas specifikimeve teknike.

Disponimi i punonjësve do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së dëshmime/certifikatave të kualifikimit përkatëse të kërkuara më sipër, të lëshuar nga institucione kombëtare/ndërkombëtare të liçensuara/të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalent, por mjafton të jenë të certifikuar për njohuri të ngjashme me ato të kërkuara më sipër, duke mos kufizuar OE që gjenden në treg për tu certifikuar vetëm pranë një trupe, sipas specifikimeve përkatëse të secilës pajisje. Certifikatat duhet të jenë të verifikueshme ose të paraqiten kontakte të vlefshme në rast nevojë për verifikim. Konkretisht, është kërkuar:

- 1 (një) punonjës i certifikuar për menaxhimin e projekteve, gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës, kohëzgjatjes të saj (përfshi garancitë) dhe rëndësisë operationale, ku të gjitha këto duhet domosdoshmërisht të ndiqen nga një profesionist i kualifikuar në menaxhimin e projekteve të zbatimit, si dhe koordinuar me sukses proceset e punës ndërmjet stafit të ekspertëve profesioniste të OE fitues me stafin e AK-se, nga fillimi (nënshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku i mosrealizimit të kontratës për arsye menaxheriale. Ky lloj certifikimi është standard i kërkuar gjerësisht, dhe garanton AK se OE ka kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertizë të thelluar në menaxhimin e projekteve, kredibilitet profesional si dhe shërben si një pikë kontakti nga ana e AK gjatë zbatimit të kontratës.
- 1 (një) i punonjës të certifikuar në fushën e pajisjeve fotografike të ofertuara ose ekuivalent, nga prodhuesi përkatës, për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të seteve fotografike, audiove dhe kamerave, si dhe suportin gjatë kohës së garancisë.

Në funksion të vërtetimit të reputacionit, besueshmërisë dhe përvojës së duhur, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se për periudhën e 3(tre) muajve të fundit, kanë patur në dispozicion punonjësit të certifikuar si më sipër dhe për këtë duhet të paraqesin listë pagesat e plotësuar rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma

ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikata që kërkohet duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit:

- **ISO 9001:2015** (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e certifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike dhe në varësi të zërave përkatës të preventivit. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

**Certifikimi ISO 9001** na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Paraqitja e ISO-s tregon se, OE zbatojnë sistemet e manaxhimit në përputhje me këto standarde dhe rrisin performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues. ISO duhet të jenë në emër të shoqërive dhe në objektet e këtyre certifikatave duhet të jetë përfshirë objekti i prokurimit.

**2.4.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikujt kryesorë objekt prokurimi me nr.rendor 2, 4, 16, 23, 26 të shtojcës 7, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit që e ka lëshuar këtë dokument, si: telefoni/e-mail/website, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Referuar nënit 77, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Si dhe pika 4, [...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.]*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”*

*Duke qenë se Autoriteti kontraktor, është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.*

*Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:*

- *Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar;*

- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit;
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përfitim e mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

1- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

2- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

3- Operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mjeteve. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kerkoje garanci mbi cilësinë e shërbimit dhe llojit të mjetit të ofruar, si dhe përfshirjen e vet shërbimeve dhe suportit të prodhuesit/ distributorit zyrtar në këtë kontratë.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi/distributori i autorizuar, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të mjeteve të ofertuara dhe nevojës për garanci mbi efikasitetin dhe kapacitetet teknike të tyre.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit/vendosjes e instalimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së garancisë, si dhe me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara mbi prodhuesin.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në këtë proces. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me mallra të realizohet me sukses dhe pa probleme të panevojshme.

**2.4.3** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogë/ broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve dhe të plotësojë tabelën me të dhënat sipas formatit të mëposhtëm, për artikujt kryesorë objekt prokurimi me nr.rendor 2,4,16,23,26 të shtojcës 7, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike me kërkesat në DT, sipas shtojcës 7.

<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
<b>Nr. rendor shtojca 6</b>	<b>Emërtimi i artikullit</b>	<b>Duhet paraqitur MAF/DAF per pajisjet</b>	<b>Kompania prodhuese</b>	<b>Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve</b>
<b>2</b>	Laptop			
<b>4</b>	Storage 160 Terra			
<b>16</b>	Set aparati fotografik i tipit I			
<b>23</b>	Set aparati fotografik Tipit II			
<b>26</b>	Set Aparati fotografik i Tipit III			

Shënim:

- Numrat rendor i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 7 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit".

- Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Konkretisht në kolonën E, të tabelës, operatorët ekonomikë duhet të japin një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike për artikujt e specifikuar, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 6 të DT.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 6/b, i cili përcakton se :

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

...b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose” ...

Katalogu/fragment katalogut i pajisjeve tregon te dhenat teknike lidhur me pajisjet, sikurse jane : lloji i mjetit forma, dimensionit,..etj).

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Së pari, paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth tyre. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë e pajisjeve që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që pajisjet e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Kjo do të shërbejë që KVO të gjykojë dhe vlerësojë mbi karakteristikat teknike të pajisjeve të ofertuara bazuar në katalogët përkatës të lëshuar nga prodhuesi nëse ato përputhen apo jo me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Së treti, OE duhet të paraqesin katalogë/ broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/eve, për artikujt e cilësuar të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë prodhuesin, markën dhe modelin e mallit që ofertojnë, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike me kërkesat në DT dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues.

Kërkesa për autorizimin e prodhuesve/distributorit dhe katalogut është vendosur vetëm për pajisjet kryesore që kanë nevojë për instalim, konfigurim dhe vënie në punë dhe që kanë vlerë të konsiderueshme. Dhe nuk është kërkuar për pajisje të cilat nuk kanë nevojë për instalim apo kanë proces instalimi të thjeshtë që mund të kryhet edhe nga persona jo të specializuar, si psh. mikrofona, kufje, kablllo, aksesorë, etj.

**2.4.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetdeklarim që:

- merr përsipër furnizimin, transportin, instalimin, konfigurimin dhe vënien në punë të pajisjeve objekt prokurimi.
- garancia e mallrave do të jetë jo më pak se 1 vit ose më shumë nëse kërkohet ndryshe në specifikimet teknike, nga momenti i lëvrimit të tyre.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nënin të 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhen drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK se mallrat që do të furnizojë do të jenë origjinale e cilësore.

Deklaratat janë kërkuar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të garantojë cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të artikujve që e kanë të domosdoshëm montimin, konfigurimin dhe menaxhimin e ngritjes së komplet rrjetit multimedial, si dhe do të kryejë transportin deri në destinacion dhe do të mbulojë dëmtimet brenda periudhës së garancisë. Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulojnë dëmtimet brenda periudhës së garancisë. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me pikën 8, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përveç

kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojnë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

---

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojnë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

**b. Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softwerike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Përmirësimi i Sistemit Audio-Video**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

### **Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për

realizimin e objektit: **“Përmirësimi i Sistemit Audio-Video”**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për çmimin pajisjeve specialeve, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën **“Përmirësimi i Sistemit Audio-Video”**”.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për pajisje audio dhe video, aparate fotografik dhe aksesore të tjerë në funksion të përmirësimit të sistemit të monitorimit të medias dhe komunikimit, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, pika 3/b, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.*

*Nëse ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN, mbi komformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

*Kudo ku përdoret markë specifike prodhimi apo e njëjtë me të, do të pranohet ose ekuivalent i saj, vetëm në raste përjashtimore, të jashtëzakonshme kur marka është përdorur/ kërkuar për arsye të produkteve/ artikujve të cilat disponohen nga AK dhe kërkojnë aksesore shtesë apo zëvendësues në funksion të pajisjes.*

**Shoqëritë ofertuese duhet të përmbushin këto kushte:**

- Garancia (skadenca) e mallrave do të jetë jo më pak se 1 vit ose më shumë nëse kërkohet ndryshe në specifikimet teknike, nga momenti i lëvrimit të tyre.
- OE duhet të marrë përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallrave të furnizuara në adresën fundore të njësisë së AK.
- OE duhet të marrë masa paraprake që në momentin e hartimit të ofertës teknike të mos dalin probleme me cilësinë gjatë zbatimit të kontratës.
- Nëse është përmendur ndonjë markë, është për efekt të saktësimit të llojit të pajisjes për të cilin kërkohet artikulli, i cili mund të jetë edhe ekuivalent, por gjithnjë duke plotësuar specifikimet e kërkuara nga AK.
- Specifikimet teknike minimale të nevojshme për tu plotësuar si më poshtë, janë hartuar në varësi të nevojave të punës që ka Drejtoria e Medias dhe Komunikimit.

**Afatet e lëvrimit dhe vendi i dorëzimit të mallit:** Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga lidhja e kontratës. Lejohet lëvrimi i pjesshëm i mjeteve, brenda këtyre afateve. Artikujt duhet të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Tiranë.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Përmirësimi i Sistemit Audio-Video”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**NJËSIA E PROKURIMIT**



